

PROCESVERBAL

PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE KRITEREVE PËR KUALIFIKIM

(Ky procesverbal është për efekt publikimi bashkë me dokumentet e tenderit)

OBJEKTI I PROKURIMIT: “Ndërhyrje për ngritjen e modeleve të qëndrueshme SMECO në zona urbane me potencial zhvillimi: Ndërhyrje për përmirësimin e aksesit turistik, pika panoramike (viewpoint), përgjatë rrugës panoramike Kaninë – Vlorë, Bashkia Vlorë.

KODI PËRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV): 45000000-7.

Fondi limit: 46,377,257.13 lekë pa TVSH.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Fondi Shqiptar i Zhvillimit ka hartuar procesverbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë:

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë:

- a. *Formularin Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8,*
- b. *Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;*

Argumentimi: Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë:

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme):

Kjo pikë përmbushet sipas pikës 1/a) të Kriterëve të Përgjithshme (*Vetëdeklarimi sipas shtojcës 8*)

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar:

2.2.1. Për të provuar kapacitetet financiare dhe ekonomike, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për vitet financiare **2022, 2023, 2024** ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e përlllogaritur e fondit limit në procedurën e prokurimit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe pika 2/b e nenin 43, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë:

Kjo vlerë për xhiron vjetore është kërkuar pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndermjet kufirit të lartë monetar dhe të ulët monetar.

Shënim: Duke qenë se aktet ligjore dhe nënligjore parashikojnë një marzh për vlerën e xhiros që mund të kërkohej, autoritetet/entet kontraktore duhet të argumentojnë vlerën e kërkuar të xhiros brenda këtij marzhi.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e vërtetimit të xhiros vjetore është bërë bazuar ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”.

AK në miratimin e këtij kriteri ka mbajtur në vëmendje nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore”: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.”

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për vitet financiare **2022, 2023, 2024** të shoqëruara me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, në rastin kur janë në kushtet e përcaktimeve neni 41, pika ”c”, të Ligjit nr. 10091, datë 5.03.2009 “Për auditimin ligjor, organizimin e profesionit të audituesit ligjor dhe të kontabilistit të miratuar”, i ndryshuar, ku dy bilancet e njëpasnjëshme të kërkuara, nuk duhet të kenë raport negativ ndërmjet aktivitetit dhe pasivit.

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, i ndryshuar si dhe nenit 43, pika 4, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar për të vërtetuar një aktivitet pozitiv të qendrueshëm.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e balanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438, datë 28.12.1998 "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr.5, datë 30.01.2006, "Për tatimin mbi të ardhurat", i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare”. Referuar në nenin 29 të Ligjit Nr. 8438, datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat tatimore: “Çdo tatimpagues përgatit deklaratën vjetore të të ardhurave të tatueshme në formën e përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji. Tatimpaguesit paraqesin deklaratën vjetore në organet tatimore brenda datës 31 mars të vitit pasardhës, duke paraqitur në të njëjtën kohë bilancin kontabël, së bashku me anekset e tij, si dhe çdo të dhënë tjetër të përcaktuar në udhëzimin e Ministrit të Financave në zbatim të këtij ligji.

Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizen e Ekspertit Kontabel të Autorizuar, është bërë duke iu referuar parashikimit në nenit 41 shkronja b” të Ligjit nr. 1009/2009: “*Detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, individuale apo të konsoliduara, përpara publikimit të tyre: "b) të gjitha njësitë ekonomike dhe grupet e njërive ekonomike, të cilat në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vjet radhazi, tejkalojnë dy prej tre treguesve të mëposhtëm: i. totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse arrin ose e kalon shumën prej 50 000 000 (pesëdhjetë milionë) lekësh; ii. shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 000 000 (njëqind milionë) lekësh; iii. ka mesatarisht të paktën 50 (pesëdhjetë) të punësuar gjatë periudhës kontabël".*

2.3 Kapaciteti teknik:

2.3.1. Operatori ekonomik duhet të paraqesë dëshmi për përvojën e mëparshme të ngjashme:

a) punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përllogaritur të kontratës që prokurohet dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës, ose

b) punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet.

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e bën ofertën të kualifikueshme.

Pika 2.3.1/a, plotësohet nga anëtari i cili ka përqindjen më të madhe të pjesëmarrjes në bashkim. Anëtarët e tjerë të bashkimit do të paraqesin kontratat e ngjashme në raport me përqindjen e pjesëmarrjes së tyre në bashkim.

Për të vërtetuar përvojën e mëparshme të ngjashme, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin dëshmitë e mëposhtme: Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin publik, duhet të paraqiten vërtetime të lëshuara nga një ent publik, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë.

Në rastin e përvojës së mëparshme të realizuar me sektorin privat, duhet të paraqiten vërtetime, për përmbushjen me sukses të kontratës, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, e shoqëruar me:

- Kontratën/at e Sipërmarrjes
- Fature tatimore e situacionit perfunditar të deklaruar në organet tatimore

- Situacioni përfundimtar
- Akt kolaudimi;

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, i ndryshuar dhe nenit 39, pika 5 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerën 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit që prokurohet për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar. Përcaktimi i vlerës së kërkuar për kontratat e ngjashme argumentohet si më poshtë:

Pasi vlera e parashikuar e kontratës, është ndërmjet kufirit të ulët dhe kufirit të lartë monetar. Vlera për punë të ngjashme përbën një nivel të mjaftueshëm përvojë duke patur parashysh objektin dhe vlerën e kontratës.

Përvoja e mëparshme është element shumë i nevojshëm që garanton autoritetin, se operatorët ekonomikë mbi bazën e vlerës së punëve të ngjashme zotërojnë kapacitete për të zbatuar kontratën me sukses sipas një standarti të përshtatshëm cilësie. Në mbështetje të nenit 88 pika 1 e VKM 285/2021, parashikon se “Oferta mund të paraqitet nga një bashkim operatorësh ekonomikë, sipas përcaktimit të pikave 2 dhe 3, të nenit 14, të LPP-së, ku njëri prej të cilëve i përfaqëson të tjerët gjatë procedurës dhe, në rast përzgjedhjeje, edhe gjatë zbatimit të kontratës. Në ofertë duhet të përcaktohet pjesa e shërbimit, punës ose furnizimit, që do të kryejë secili nga anëtarët e këtij bashkimi nëpërmjet një kontrate bashkëpunimi të hartuar ndërmjet palëve.

2.3.2 Operatori ekonomik duhet të paraqesë licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë bazuar në formatin e miratuar me Vendim të Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve. Licenca duhet të përmbajë kategoritë e punimeve të kontratës si më poshtë:

PËR PUNIMET E PËRGJITHSHME TË NDËRTIMIT

N.P -	1.	A	Punime gërmimi në tokë.
N.P -	2.	A	Ndertime civile dhe industriale
N.P -	3.	A	Rikonstrukcion dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada
N.P -	4.	A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale.
N.P -	7.	A	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje.
N.P -	11.	A	Ndertime për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë
N.P -	12.	A	Punime të inxhinierisë së mjedisit

PËR PUNIMET SPECIALE TË NDËRTIMIT

N.S –	2.	A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre
N.S –	4.	A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese
N.S –	6.	A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese
N.S –	8.	A	Ndertime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri.
N.S –	9.	A	Punime strukturorë speciale
N.S -	18.	A	Punime topogjeodezike.

Operatorët e huaj duhet të bëjnë ekuivalentimin e licencave profesionale që disponojnë të lëshuara nga vendi i origjinës, pranë Ministrisë së Infrastrukturës dhe Energjisë, Republika e Shqipërisë. (Rregullorja për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve

juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi, e miratuar me VKM-në Nr. 42, datë 16.01.2008). Mosparaqitja në këtë formë është kusht skualifikues

Argumentimi: Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe Vendimin e Keshillit të Ministrave Nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe procedurat e dhënies së licencave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”. Te dhënat për licencat e mësipërme janë vendosur referuar bazës ligjore për ndërtimet, ligjit nr. 8402 datë 10.9.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit” të ndryshuar, neni 8 përcakton "Zbatimi i punimeve të ndërtimit kryhet vetëm nga persona juridikë, privatë ose publikë, vendas ose të huaj, të pajisur me licencën përkatëse, për zbatim punimesh ndërtimore. Zbatuesi i punimeve mban përgjegjësi dhe është i detyruar të realizojë punimet e ndërtimit, në përputhje me lejen e ndërtimit, projektin, kushtet teknike të zbatimit dhe rregullat e sigurimit teknik. Ai duhet të sigurojë cilësinë e materialeve të ndërtimit dhe produkteve të ndërtimit, të cilat duhet të plotësojnë kërkesat e projektit në përputhje me standartet kombëtare ose europiane. Kategoritë janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, si më poshtë:

ARGUMENTIMI LICENCAT

Kategoria e kërkuar	Pershkrimi i kategorisë sipas legjislacionit të fushës	Zërat e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	Niveli i klasifikimit i kërkuar për kategorinë respektive	Vlera e punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
N.P-1. A	Punime gërmimi në tokë	- Gërmim dheu me krah e transport k dore 10mkat III/Excavation by manwork, including transport by carrying 10m, kat III - Transport materiale ndërtimi dheu me auto deri 5.0 km/Trasportation of excavated soil with auto until 5 km - Gërmim dheu me krah e transport k dore 10mkat III / Excavation by manwork, including transport by carrying 10m, kat III - Gërmim dheu me krah e transport k dore 10mkat III / Excavation by manwork, including transport by carrying 10m, kat III - Gërmim dheu themele e plinta me b-2m ekskavator me zinxhir 0.25m³shkarkimi ne auto / Excavation for foundation works, width 2m, with crawler escavator 0.25m³, discharge by	0-20 mln leke	3,904,685 leke

		auto - Germim shkemb mesatar me çekik me ekskavator me zinxhir / Excavation of medium rock with hummer excavator - Germim shkemb i forte me çekik me ekskavator me zinxhir / Excavation of hard rock with hummer excavator - Transport materiale ndertimi dheu me auto deri 5.0 km/ Transportation of excavated soil with auto until 5 km - Mbushje rafshim ngjeshje me tokmak elektrik cdo 30 cm te te zakonshme/Filling, compaction with an electric tamper every 30 cm of ordinary soil - Mbushje rafshim ngjeshje me tokmak elektrik cdo 30 cm te te zakonshme/Filling, compaction with an electric tamper every 30 cm of ordinary soil		
N.P- 2 A	Ndertime civile dhe industriale.	- Shtrese betoni C20/25/C20/25 Concrete Layer - Shtrese stirobetoni/Lightweight Concrete Layer - Shtrese lluster cimento 1:2/Cement Mortar Layer 1:2 - Shtrese me pllaka grez importi 40x40cm/Layer with Imported 40x40 cm Tiles - Shtrese rere/Sand Layer - F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm/S.I Periodic Reinforcing Steel Bars Ø 6 - 10 mm - F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm/S.I Periodic Reinforcing Steel Bars Ø 6 - 10 mm - F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm/S.I Periodic Reinforcing Steel Bars Ø > 12 mm - Mure b/a t = 21-30cm h ~ 4m C 20/25/Concrete Wall t = 21-30 cm, h ~ 4 m, C 20/25 - Struktura monolite betoni C	0-20 mln leke	14,595,878 leke

		12/15/Monolithic Structure Concrete C 12/15 - Struktura monolite betoni C 25/30 (Pilota) hiqet kallepi nga vlera e cmimit./Monolithic Structure Concrete C 25/30 (Piles), excluding the cost of excavation - Struktura te holla monolite betoni C 20/25/Thin Monolithic Structure Concrete C 20/25 - Struktura monolite betoni C 25/30/Monolithic Structure Concrete C 25/30		
N.P-3 A	Rikonstruksi on dhe mirëmbajtje godinash civile e industriale, veshje fasada	- Veshje fasade me corten/Facade cladding with corten - Veshje fasade me listela lte stazhionuara dhe rezistente kundra faktoreve atmosferike./Facade cladding with seasoned slats that are resistant to atmospheric factors	0-20 mln leke	796,730 leke
N.P-4 A	Rrugë, autostrada, mbikalime, hekurudha, tramvai, metro, pista aeroportuale	- Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm perhapur e ngjeshur me makineri/Layer of gravel waste, thickness = 20 cm, spread and compacted with machinery - Shtrese stabilizant t=15cm/Shtrese stabilizant t=15cm - Mbushje me cakell e gur gurore ne trupin e rruges perhapur e ngjeshur me makineri/Filling with gravel and stone in the roadbed, spread and compacted with machinery	0-20 mln leke	5,669,648 leke
N.P-7 A	Ujesjellesa, gazsjellesa, vajsjellesa, vepra kullimi e vaditje	- FV Tuba e rakorderi ujesjellesi PPR d=20~25mm Pn 25/S.I PPR Water Supply Pipe and Fittings d=20~25 mm PN 25 - F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110/S.I PVC Sewer Pipe Ø 110 - F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 140/S.I PVC Sewer Pipe Ø 140 - F.V Kolektor shpendares 3/4" (4+4)/ S.I Distribution Collector 3/4" (4+4) - Pusete shkarkimi 50 x 50 h = 100 cm/Discharge Manhole 50 x	0-20 mln leke	1,208,864 leke

		50 h = 100 cm - Grope septike me V = 6 m3 -		
N.P-11 A	Ndërtim për N/stacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë	- Projektor inkaso IP68 me mundësi montimi në tokë 9W 3000K/IP68 recessed projector with ground mounting option, 9W, 3000K - Ndriçues Shtyllor dekorativ sipas specifikimeve/Decorative pole light according to specifications - Kabull bakri Fror 5G6 mm ² /Copper cable Fror 5G6 mm ² - Kabull bakri Fror 3G6 mm ² /Copper cable Fror 3G6 mm ² - Kabull bakri Fror 3G2.5 mm ² /Copper cable Fror 3G2.5 mm ² - Puseta 20x20cm/20x20 cm manhole - Kuti shpërndarëse jashtë muri 190x140x70/Outdoor distribution box 190x140x70 mm - Tub fleksibel D 25mm/Flexible pipe, diameter 25 mm - Tub corrugat D 40mm/Corrugated pipe, diameter 40 mm - FV Kuadër komandimi komplet me santeri + fotoelement/S.I Complete control frame with sensor + photoelement - Shirit LED IP 68 12 VDC 15W/m 2700K aksesore fiksime dhe Transformator/LED strip IP68 12 VDC 15W/m 2700K with fixing accessories and transformer - Tub corrugat D 63mm/Corrugated pipe, diameter 63 mm - Kabull bakri Fror 3G1.5 mm ² /Copper cable Fror 3G1.5 mm ² - Sensore Levizje 360grade/360 degree motion sensors - Ndriçues rrethor, 20W, 230V, 4000K, 1 550 lm, dimensions: 220 × 78 mm, IP54, ngjyrë të bardhë/Circular lamp, 20W, 230V, 4000K, 1 550 lm, dimensions: 220 × 78 mm, IP54,	0-20 mln leke	4,656,405 leke

		white color - Prize Elektrike e kompletuar me kuti, suport dhe kapak/ Electrical Socket completed with box, suport and frame - Panel diellor për ngrohjen e ujit sanitar 300 l - "Ndriçues emergjence Lartësia: H3 cm Lloji i ndriçimit: 6500 K Koha e aktivizimit: <0.5 s Kohëzgjatja: 3-8 ore Fluksi i ndriçimit: 150 lm Fuqia: 2 W Përmasat: 20.5x6. cm Marka: BRAYTRON/Emergency light Height: H3 cm - Type of lighting: 6500 K Activation time: <0.5 s - Duration: 3-8 hours Lighting flux: 150 lm - Power: 2 W Dimensions: 20.5x6 cm Brand: BRAYTRON"		
N.P-12 A	Punime te inxhinerise se mjedisit	- F.V. Dhe humusore/S.I Topsoil and Humus - Mbjellje bari ne skarpas/Grass Planting on Slopes - F.V. Pemë dekorative akacie/S.I Decorative acacia tree - F.V. Pemë frutore të zonës (Ullinj)/S.I Fruit trees of the area (Olives) - F.V shkurre dekorative Juniperus V.18 grup 3 cdo 6.6m/S.I Decorative Shrubs Juniperus V. 18 Group 3 every 6.6 m	0-20 mln leke	575,298 leke
N.S-2. A	Impiante hidro-sanitare, kuzhina, lvanteri, mirëmbajtja e tyre	- F.V lavaman porcelani/S.I Porcelain Sink - F.V lavaman porcelani/S.I Porcelain Sink - F.V WC allafrenga/S.I WC with Flushing System - F.V WC allafrenga/S.I WC with Flushing System - F.V pilete dyshemeje Ø 50/S.I Floor Drain Ø 50	0-20 mln leke	210,429 leke

N.S-4. A	Punime rifiniture të muraturës dhe të lidhura me to, rifiniture me materiale druri, plastik, metalik dhe xhami dhe rifiniture të natyrës teknike ndërtuese	- Hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum/Waterproofing with Emulsion and 2 Layers of Bitumen - Mbulim çatie me panele sandwich/Roof Covering with Sandwich Panels - Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100/Vertical Drainage Well with Galvanized Sheet Metal Ø 100 - Veshje tavani me kartonxhes/Ceiling Finish with Gypsum Board - F V dyer d/alumini plastike me dopio xham/S.I Aluminum-Plastic Doors with Double Glazing - F V dritare d/alumini plastike me dopio xham/S.I Aluminum-Plastic Windows with Double Glazing - Boje vaji sipërfaqe druri/Oil Paint for Wood Surfaces - Boje vaji sipërfaqe metalik/Oil Paint for Metal Surfaces	0-20 mln leke	1,157,900 leke
N.S-6.A	Sinjalistika rrugore jo ndriçuese	- Tabele informuese emri I pikes panoramike me korten/Informative table with the name of the viewpoint made of corten - Tabele informuese emri I pikes panoramike metalike/Informative table with the name of the viewpoint made of metal - Tabele informuese modeli 2/Informative table model 2	0-20 mln leke	44,736 leke
N.S-8. A	Ndërttime parafabrikat beton arme, struktura metalike dhe druri	- F V konstruksione metalike te thjeshta/S.I Simple Metal Structures - Panele metalike Corten korimano/Corten corimano metal panels - Shtrese derrasa te stazhionuara kundra faktoreve atmosferike ./Layers of boards seasoned against atmospheric factors. - Stola betoni me ngjyrosje 45x45x600 cm/Concrete benches	0-20 mln leke	7,009,395 leke

		with coloring, measuring 45x45x600 cm - Stola betoni me ngjyrosje 45x45x250 cm/Concrete benches with coloring, measuring 45x45x250 cm - Stola betoni me ngjyrosje 45x45x45 cm/Concrete benches with coloring, measuring 45x45x45 cm - Kosh mbeturinash corten/Corten trash bin - Kosh mbeturinash metalik/Metal trash bin		
N.S-9. A	Punime strukturorë speciale	- Shpim me sonda në zhavore Ø120cm thellësia (0-20m)/Drilling with Piles in Gravel Ø 120 cm, Depth (0-20 m)	0-20 mln leke	1,321,234 leke
N.S-18. A	Punime topogjeodezi ke.	- Referuar projektit te zbatimit dhe relacionit teknik	0-20 mln leke	

2.3.3 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të ketë stafin drejtues teknik të punësuar dhe regjistruar si më poshtë::

- 1 (nje) Inxhinier Ndërtimi
- 1 (nje) Inxhinier Hidroteknik
- 1 (nje) Inxhinier Mekanik
- 1 (nje) Inxhinier Mjedesi
- 1 (nje) Inxhinier Gjeodet
- 1 (nje) Inxhinier Elektrik

Për të dëshmuar përmbushjen e kriterit 2.3.3 operatori ekonomik duhet të paraqesë:

- Diploma
- CV
- Kontrata e punës

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas Shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe neni 39 pika 6/c të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Kriteri për stafin drejtues teknik, lidhet ngushtësisht me objektin e kontratës, projektin e zbatimit, specifikimet teknike, raportet teknik dhe volumet e punimeve. Nevoja për inxhinierët në objekt është e diktuar nga përvoja dhe legjislacioni për punimet e ndërtimit. Mungesa e këtij stafi pothuajse në çdo rast rezulton në realizim jashtë afatit, jashtë normave dhe me cilësi të dobët të objekteve. Numri i stafit kryesor teknik është përcaktuar nga pikëpamja e natyrës teknike të kontratës me qëllimin për të patur një rezultat sa më të mirë në mbarëvajtjen dhe zbatimin e punimeve. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, për të zbatuar kontratën. Drejtuesi i projektit është përgjegjës për ndërtimin objektiv në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë brenda kushteve të kontratës

Punimet apo veprimtaritë konkrete për të cilat kërkohet ekspertiza e tyre profesionale janë:

ARGUMENTIMI STAFI DREJTUES

Inxhinier Ndërtimi	- Germim dheu me krah e transport k dore 10mkat III/Excavation by manwork, including transport by carrying 10m, kat III - Transport materiale ndertimi dheu me auto deri 5.0 km/ Trasnportation of excavated soil with auto until 5 km - Germim dheu me krah e transport k dore 10mkat III / Excavation by manwork, including transport by carrying 10m, kat III - Germim dheu me krah e transport k dore 10mkat III / Excavation by manwork, including transport by carrying 10m, kat III - Germim dheu themele e plinta me b-2m ekskavator me zinxhir 0.25m3shkarkimi ne auto / Excavation for foundation works, width 2m, with crawler excavator 0.25m3, discharge by auto - Germim shkambi mesatar me çekiç me ekskavator me zinxhir / Excavation of medium rock with hummer excavator - Germim shkemb i forte me çekiç me ekskavator me zinxhir /
--------------------	--

	Excavation of hard rock with hammer excavator - Transport materials on time and then by car 5.0 km/ Transportation of excavated soil with car until 5 km - Mbushje rrafshim ngjeshje me tokmak elektrik cdo 30 cm toke te zakonshme/Filling, compaction with an electric tamper every 30 cm of ordinary soil - Mbushje rrafshimngjeshje me tokmak elektrik cdo 30 cm toke te zakonshme/Filling, compaction with an electric tamper every 30 cm of ordinary soil - Shtrese betoni C20/25/Concrete Layer - Shtrese stirobetoni/Lightweight Concrete Layer - Shtrese llusterimento 1:2/Cement Mortar Layer 1:2 - Shtrese me pllaka grez importi 40x40cm/Layer with Imported 40x40 cm Tiles - Shtrese rere/Sand Layer - F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm/S.I Periodic Reinforcing Steel Bars Ø 6 - 10 mm - F V hekur betoni periodik Ø 6 - 10 mm/S.I Periodic Reinforcing Steel Bars Ø 6 - 10 mm - F V hekur betoni periodik Ø > 12 mm/S.I Periodic Reinforcing Steel Bars Ø > 12 mm - Mure b/a t = 21-30cm h ~ 4m C 20/25/Concrete Wall t = 21-30 cm, h ~ 4 m, C 20/25 - Struktura monolite betoni C 12/15/Monolithic Structure Concrete C 12/15 - Struktura monolite betoni C 25/30 (Pilota) hiqet kallepi nga vlera e cmimit./Monolithic Structure Concrete C 25/30 (Piles), excluding the cost of excavation - Struktura te holla monolite betoni C 20/25/Thin Monolithic Structure Concrete C 20/25 - Struktura monolite betoni C 25/30/Monolithic Structure Concrete C 25/30 - Veshje fasade me corten/Facade cladding with corten - Veshje fasade me listela lte stazhionuara dhe rezistente kundra faktoreve atmosferike./Facade cladding with seasoned slats that are resistant to atmospheric factors - Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm perhapur e ngjeshur me makineri/Layer of gravel waste, thickness = 20 cm, spread and compacted with machinery - Shtrese stabilizant t=15cm/Shtrese stabilizant t=15cm - Mbushje me çakell e gur guror ne trupin e rruges perhapur e ngjeshur me makineri/Filling with gravel and stone in the roadbed, spread and compacted with machinery - Hidroizolim me emulsion dhe 2 bitum/Waterproofing with Emulsion and 2 Layers of Bitumen - Mbulim çatie me panele sandwich/Roof Covering with Sandwich Panels - Ulluk shkarkimi vertikal me llamarine xingat Ø 100/Vertical Drainage Well with Galvanized Sheet Metal Ø 100 - Veshje tavani me kartonxhes/Ceiling Finish with Gypsum Board - F V dyer d/alumini plastike me dopio xham/S.I Aluminum-Plastic Doors with Double Glazing
--	--

	- F V dritare d/alumini plastike me dopio xham/S.I Aluminum-Plastic Windows with Double Glazing - Boje vaji sipërfaqe druri/Oil Paint for Wood Surfaces - Boje vaji sipërfaqe metalik/Oil Paint for Metal Surfaces - Shpim me sonda në zhavore Ø120cm thellësia (0-20m)/Drilling with Piles in Gravel Ø 120 cm, Depth (0-20 m)
Inxhinier Hidroteknik	- FV Tuba e rakorderi ujësjes PPR d=20~25mm Pn 25/S.I PPR Water Supply Pipe and Fittings d=20~25 mm PN 25 - F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 110/S.I PVC Sewer Pipe Ø 110 - F.V. Tub kanalizimi pvc Ø 140/S.I PVC Sewer Pipe Ø 140 - F.V Kolektor shpendares 3/4" (4+4)/ S.I Distribution Collector 3/4" (4+4) - Pusete shkarkimi 50 x 50 h = 100 cm/Discharge Manhole 50 x 50 h = 100 cm - Grope septike me V = 6 m³ - F.V lavaman porcelani/S.I Porcelain Sink - F.V lavaman porcelani/S.I Porcelain Sink - F.V WC allafrenga/S.I WC with Flushing System - F.V WC allafrenga/S.I WC with Flushing System - F.V pilete dysHEMEJE Ø 50/S.I Floor Drain Ø 50
Inxhinier Mekanik	- Tabele informuese emri I pikes panoramike me korten/Informative table with the name of the viewpoint made of corten - Tabele informuese emri I pikes panoramike metalike/Informative table with the name of the viewpoint made of metal - Tabele informuese modeli 2/Informative table model 2 - F V konstruksione metalike te thjeshta/S.I Simple Metal Structures - Panele metalike Corten korimano/Corten corimano metal panels - Shtrese derrasa te stazhionuara kundra faktoreve atmosferike ./Layers of boards seasoned against atmospheric factors. - Stola betoni me ngjyrosje 45x45x600 cm/Concrete benches with coloring, measuring 45x45x600 cm - Stola betoni me ngjyrosje 45x45x250 cm/Concrete benches with coloring, measuring 45x45x250 cm - Stola betoni me ngjyrosje 45x45x45 cm/Concrete benches with coloring, measuring 45x45x45 cm - Kosh mbeturinash corten/Corten trash bin - Kosh mbeturinash metalik/Metal trash bin
Inxhinier Mjeditë	- F.V. Dhe humusore/S.I Topsoil and Humus - Mbjellje bari ne skarpas/Grass Planting on Slopes - F.V. Pemë dekorative akacie/S.I Decorative acacia tree - F.V. Pemë frutore të zonës (Ullinj)/S.I Fruit trees of the area (Olives) - F.V shkurre dekorative Juniperus V.18 grup 3 cdo 6.6m/S.I Decorative Shrubs Juniperus V. 18 Group 3 every 6.6 m
Inxhinier Elektrik	- Projektor inkaso IP68 me mundësi montimi ne toke 9W 3000K/IP68 recessed projector with ground mounting option, 9W, 3000K - Ndricues Shtyllor dekorativ sipas specifikimeve/Decorative pole light according to specifications - Kabull bakri Fror 5G6 mm²/Copper cable Fror 5G6 mm² - Kabull bakri Fror 3G6 mm²/Copper cable Fror 3G6 mm² - Kabull bakri Fror 3G2.5 mm²/Copper cable Fror 3G2.5 mm² - Puseta 20x20cm/20x20 cm manhole - Kuti shpërndarëse jashtë muri 190x140x70/Outdoor distribution box

	190x140x70 mm - Tub fleksibel D 25mm/Flexible pipe, diameter 25 mm - Tub corrugat D 40mm/Corrugated pipe, diameter 40 mm - FV Kuadër komandimi komplet me santeri + fotoelement/S.I Complete control frame with sensor + photoelement - Shirit LED IP 68 12 VDC 15W/m 2700K aksesore fiksimi dhe Transformator/LED strip IP68 12 VDC 15W/m 2700K with fixing accessories and transformer - Tub corrugat D 63mm/Corrugated pipe, diameter 63 mm - Kabull bakri Fror 3G1.5 mm²/Copper cable Fror 3G1.5 mm² - Sensore Levizje 360grade/360 degree motion sensors - Ndriçues rrethor, 20W, 230V, 4000K, 1 550 lm, dimensions: 220 × 78 mm, IP54, ngjyrë të bardhë/Circular lamp, 20W, 230V, 4000K, 1 550 lm, dimensions: 220 × 78 mm, IP54, white color - Prize Elektrike e kompletuar me kuti, suport dhe kapak/ Electrical Socket completed with box, suport and frame - Panel diellor për ngrohjen e ujit sanitar 300 l - "Ndriçues emergjence Lartësia: H3 cm Lloji i ndriçimit: 6500 K Koha e aktivizimit: <0.5 s Kohëzgjatja: 3-8 ore Fluksi i ndriçimit: 150 lm Fuqia: 2 W Përmasat: 20.5x6. cm Marka: BRAYTRON/Emergency light Height: H3 cm - Type of lighting: 6500 K Activation time: <0.5 s - Duration: 3-8 hours Lighting flux: 150 lm - Power: 2 W Dimensions: 20.5x6 cm Brand: BRAYTRON"
Inxhinier Gjeodet	Referuar projektit të zbatimit dhe relacionit teknik

2.3.4. Operatori ekonomik duhet të disponojë **punonjës të specializuar/të kualifikuar**, si më poshtë:

- 1 (një) punonjes i pajisur me certifikatë “Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” e cila të jetë e lëshuar nga Kryqi i Kuq ose shoqëri të akredituara ose nga organizma ndërkombëtare akreditues të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- 1 (një) punonjës të disponojë certifikatë si "Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shëndetit në punë në përputhje me klauzolat e ligjit Nr. 10327 date 18/02/2010 "Për sigurinë dhe shëndetin në punë" dhe V.K.M nr. 312, date 05.05.2010 "Për miratimin e rregullores "Për sigurinë në kantier".

Për të dëshmuar përmbushjen e këtij kriteri, operatorët ekonomikë duhet të paraqesë:

- Diplomë/certifikatë
- CV

Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën të verifikojë prezencën në objekt të personelit të mësipërm dhe/ose të kërkojë ndryshimin/zëvendësimin e tyre me staf me kualifikime të njëjta ose më të larta, në rast konstatimi të shkeljeve të rregullave/normave përkatëse. Në rast përsëritje mund të merren masa për ndërprerjen e kontratës

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/entë kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Argumentimi 2.3.4: Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për

realizimin me sukses të kontratës. Kërkesat e mësipërme mbështen në ligjin Nr. 10327 datë 18/02/2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe V.K.M nr. 312, datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier” si dhe ligjit Nr. 10431 datë 09.6.2011 “Për mbrojtjen e mjedisit”. Natyra e kontratës dhe specifikat e sajë kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr.312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ndjekë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmë e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes. Operatori/ët ekonomik/ë, që gjatë kryerjes së ushtrimit të veprimtarisë, duhet të ketë/në kualifikimet dhe dokumentat përkatëse lidhur me ndikimin në mjedis dhe rehabilitimit të mjedisit, për raste ndotjesh siç parashikon VKM-ja nr.312/2010. Rregullat dhe procedurat e përgjithshme për garantimin e mbrojtjes në një nivel të lartë të mjedisit janë detyrim ligjor për çdo subjekt tregtar person fizik apo juridik për parandalimin dhe pakësimin e rreziqeve ndaj jetës e shëndetit të njeriut, sigurimin dhe përmirësimin e cilësisë së jetës, në dobi të brezave të sotëm dhe të ardhshëm, si dhe sigurimin e kushteve për zhvillimin e qëndrueshëm të vendit. Garantimi i ekspertizës së mbrojtjes nga çdo rrezik dhe të papritur në punë dhe dokumentat përkatëse të personave përgjegjës i shërbejnë autoritetit për të krijuar bindjen dhe besueshmëri për realizimin e kontratës.

“Ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave” rekomandohet të jete ne kantier ne rast aksidentesh ne pune

Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjen e shendetit në punë" rekomandohet të jete ne kantier per minimizimin e aksidenteve ne pune

2.3.5 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate duhet të disponojë fuqi punëtore prej minimalisht 25 persona për periudhën, tremujoje nga data e zhvillimit të procdures e vertetuar kjo me:

- Vërtetim të lëshuar nga Sigurimet shoqërore ose Administrata Tatimore, ku të specifikohet numri i punonjësve për secilin muaj, për periudhën tre mujor e nga data e zhvillimit të tenderit,

*Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese.

Argumentimi: Autoriteti Kontraktor këtë kriter e ka bazuar në nenin 77, pika 4 të Ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik” i ndryshuar në të cilin thuhet: “Aftësia profesionale e operatorëve ekonomikë për të ofruar shërbimin, punën, mallin vlerësohet në lidhje me aftësitë organizative, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm për të zbatuar kontratën, siç është përshkruar nga autoriteti ose enti kontraktor në njoftimin e objektit të kontratës” dhe nenin 39 pika 6/ç te VKM nr.285/2021 “Për rregullat e prokurimit publik” i ndryshuar. Numri i punonjësve është përcaktuar bazuar tek faktorët si, volumet dhe kategoritë e punimeve, grafiku i punimeve, zërat e punimeve dhe orët e punës dhe pagën minimale të lejuar që duhen për të përmbushur kontratën. Numri i punonjësve dhe qëndrueshmëria e tyre në punë me kohështirje tre mujore nga data e zhvillimit të tenderit, tregon besueshmëri për autoritetin që, operatori do të përmbushë kontratën. Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, përsa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administrata tatimore e shoqëruara me listpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Punësimi i një numri të caktuar, si një nga kërkesat themelore të kualifikimit, përveç besueshmërisë së operatorëve ekonomikë, përpikët të kufizojë edhe problematikat sociale dhe shmangien e informalitetit në tregun e punës, po ashtu është një tregues i kualifikimit dhe eksperiencës që duhet të ketë kjo kategori e punonjësve. Vendosija e këtij kriteri, duke përfshirë dhe stafin teknik, është në përputhje me volumin e punës, natyrën dhe terrenin ku do të kryhen punimet. Po t’i referohemi projektit, preventivit, relacionit, matjeve përkatëse që ka bërë projektuesi

është plotësisht i justifikuar numri i punonjësve. Kriteri për kualifikim është vendosur që t'i shërbejë autoritetit për të njohur gjendjen e kapaciteteve të operatorëve të cilët nëpërmjet dokumentacionit të vërtetojnë se zotërojnë, kapacitetet teknike dhe profesionale, personelin e nevojshëm, si dhe kapacitetet organizative, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës.

Analizat teknike janë bazuar në VKM nr. 216, datë 13.4.2023 “Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar përinformatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim” Bazuar në katër elementët e strukturës së kostos (material, punëtori, makineri, transport) zëri fuqi punëtore zë rreth 27% të kostos.

Nga llogaritja e oreve të punës për të gjithë zërat e punimeve të preventivit sipas manualit të çmimeve për fuqinë punëtore konkludojmë si mëposhte:

Total ore pune= 35,200 ore

Ore/1 ditë pune= 8 ore

Total Ditë pune punëtori= 35,200 ore/8 ore= 4,400 ditë pune

Ditë pune gjithsej= 8 muaj (sipas grafikut të punimeve) * 22 ditë/muaj= 176 ditë pune

Numri i fuqisë punëtore = $4,400 \text{ ditë} / 176 \text{ ditë} = 25 \text{ punëtorë}$

Ne mënyrë të përbledhur numri i fuqisë punëtore që kërkohej për realizimin e punimeve është min **25 punëtorë**

2.3.6 Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme në pronësi, ose qira, ose kontratë furnizimi.

Mjetet	Sasia	Statusi
Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 deri 20 ton	2 cope	në pronësi ose me qira
Ekskavator me goma 0.25m3	2 cope	në pronësi ose me qira
Autobot uji	2 cope	në pronësi ose me qira
Autobetoniere	3 copë	në pronësi ose me qira
Implant prodhim betoni	1 copë	në pronësi ose me qira /kontratë furnizimi
Autovinç deri 5 ton	2 cope	në pronësi ose me qira
Gjenerator	2 copë	në pronësi ose me qira
Elektrosaldatrice	2 cope	në pronësi ose me qira
Sondë për shpime pilotash me diametër 800-1200 mm	1 copë	në pronësi ose me qira

Pajisjet dhe mjetet nuk duhet të jenë të angazhuara në asnjë kontratë tjetër publike, që bie ndesh me legjislacionin e fushës së ndërtimit, dhe do të angazhohet vetëm për realizimin e këtij objekti.

Si dëshmi për të vërtetuar disponimin e mjeteve dhe pajisjeve teknike në pronësi/qira, do të paraqiten keto dokumenta:

- Për mjetet në pronësi (që shënohen në regjistra publikë), duhet të paraqiten;- dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit (leje qarkullimi), -plus certifikatën e kontrollit teknik, -siguracionin e mjetit (te vlefshme), vërtetimin e pagesës për taksat vjetore.
- Për mjetet e siguruar me qira, duhet të paraqiten; -dokumenti që vërteton regjistrimin e tij (leje qarkullimi), plus certifikatën e kontrollit teknik, siguracionin e mjetit, (te vlefshme), vërtetimin e pagesës

per taksat vjetore, kontrata e qirase e vlefshme per te gjithë periudhen e realizimit te kontrates objekt i ketij prokurimi.

- c) Për mjetet dhe pajisjet që nuk shënohen në regjistra publike duhet të paraqiten dokumentat që vërtetojnë pronësinë e tyre, apo marrjen me qira te tij.

Operatori/et ekonomik ofertues duhet te deklaroje qe te gjitha mjetet dhe pajisjet e pershkruara, do te jene te angazhuara vetem ne kete kontrate. Mjetet te cilat rezultojne te angazhuara ne kontrata te tjera afati i zbatimit te cilave shtrihet pergjate afatit te kontrates objekt i prokurimit jane shkak skualifikimi. Autoriteti Kontraktor gezon te drejten te verifikojë dhe kontrollojë disponueshmerine e ketyre mjeteve si gjate vleresimit te ofertave ashtu edhe gjate zbatimit te kontrates.

* Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimi, sipas shtojcës nr. 8. Formulari i vetëdeklarimit duhet të përmbajë kërkesat e autoritetit. _Autoriteti/enti kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari, dorëzimin e dokumenteve provuese

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik".

Argumentimi: Numri i makinerive është përcaktuar në bazë të grafikut të detajuar për zbatimin e punimeve sipas proceseve të punës, i përgatitur nga ana e projektuesit, ku për secilën proces pune është përcaktuar lloji i makinerive dhe ditët e punës përkatëse. Në bazë të pikës 4, të nenit të 77, të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik" dhe nenit 39, pika 6/d, të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik", i ndryshuar me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë fuqinë minimale punëtore, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, si dhe mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën. Për numrin e mjeteve/makinerive të nevojshme për realizimin e kontratës, janë hartuar analizat teknike, sipas legjislacionit të fushës bazuar në VKM nr. 629, datë 15.7.2015 "Për miratimin e manualeve teknike të çmimeve të punimeve të ndërtimit dhe të analizave teknike të tyre" (Ndryshuar me VKM nr. 631, datë 26.10.2018). Numri dhe lloji i makinerive, paisjeve në pronësi / qira / kontrate furnizimi janë vlerësuar si të nevojshme në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës, duke ju referuar punimeve sipas standardeve, orëve të punës, grafikut dhe kohëzgjatjes së punimeve, specifikimeve teknike. Për të zbatuar kontratën, operatorët ekonomik duhet të përmbushin kapacitetet teknike të pajisjeve dhe aseteve të tjera fizike, për këtë janë përcaktuar edhe dokumentet konkrete që duhet të paraqesin operatorët. Nëpërmjet kapaciteteve teknike operatorët ekonomikë vërtetojnë se zotërojnë aftësinë dhe kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, aftësitë organizative. Pajisje dhe mjetet e mësipërme janë të lidhura ngushtë me objektin e kontratës dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve dhe të mundësisë së operatorit për përmbushjen me sukses të kontratës si dëshmi për mjetet dhe pajisjet sipas specifikave.

ARGUMENTIMI I MJETEVE

Mjetet	Sasia	Proceset e punes
Kamione vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 deri 20 ton	2 cope	- Germim dheu me krah e transport k dore 10mkat III/Excavation by manwork, including transport by carrying 10m, kat III
Ekskavator me goma 0.25m3	2 cope	- Transport materiale ndertimi dheu me auto deri 5.0 km/

		Trasportation of excavated soil with auto until 5 km - Germim dheu me krah e transport k dore 10m kat III / Excavation by manwork, including transport by carrying 10m, kat III - Germim dheu me krah e transport k dore 10m kat III / Excavation by manwork, including transport by carrying 10m, kat III - Germim dheu themele e plinta me b-2m ekskavator me zinxhir 0.25m³shkarkimi ne auto / Excavation for foundation works, width 2m, with crawler excavator 0.25m³, discharge by auto - Germim shkemb mesatar me çekiq me ekskavator me zinxhir / Excavation of medium rock with hummer excavator - Germim shkemb i forte me çekiq me ekskavator me zinxhir / Excavation of hard rock with hummer excavator - Transport materiale ndertimi dheu me auto deri 5.0 km / Trasportation of excavated soil with auto until 5 km - Mbushje rafshim ngjeshje me tokmak elektrik cdo 30 cm toke te zakonshme/Filling, compaction with an electric tamper every 30 cm of ordinary soil - Mbushje rafshim ngjeshje me tokmak elektrik cdo 30 cm toke te zakonshme/Filling, compaction with an electric tamper every 30 cm of ordinary soil
Autobot uji	2 cope	- Shtrese çakelli mbeturine kave t=20cm perhapur e ngjeshur me makineri/Layer of gravel waste, thickness = 20 cm, spread and compacted with machinery - Shtrese stabilizant t=15cm/Shtrese stabilizant t=15cm - Shtrese rere/Sand Layer
Autobetoniere	3 copë	- Struktura monolite betoni C 12/15/Monolithic Structure Concrete C 12/15 - Struktura monolite betoni C 25/30 (Pilota) hiqet kallepi nga vlere e cmimit./Monolithic Structure Concrete C 25/30 (Piles), excluding the cost of excavation - Struktura te holla monolite betoni C 20/25/Thin Monolithic Structure Concrete C 20/25 - Struktura monolite betoni C 25/30/Monolithic Structure Concrete C 25/30
Impiant prodhim betoni	1 copë	
Autovinç deri 5 ton	2 cope	- F V konstruksione metalike te thjeshta/S.I Simple Metal Structures - Panele metalike Corten korimano/Corten corimano metal panels - Shtrese derrasa te stazhionuara kundra faktoreve atmosferike ./Layers of boards seasoned against atmospheric factors. - Stola betoni me ngjyrosje 45x45x600 cm/Concrete benches with coloring, measuring 45x45x600 cm
Gjenerator	2 copë	
Elektrosaldatriçe	2 cope	

		- Stola betoni me ngjyrosje 45x45x250 cm/Concrete benches with coloring, measuring 45x45x250 cm - Stola betoni me ngjyrosje 45x45x45 cm/Concrete benches with coloring, measuring 45x45x45 cm - Kosh mbeturinash corten/Corten trash bin - Kosh mbeturinash metalik/Metal trash bin
Sondë për shpime pilotash me diametër 800-1200 mm	1 copë	- Shpim me sonda në zhavore Ø120cm thellësia (0-20m)/Drilling with Piles in Gravel Ø 120 cm, Depth (0-20 m)

2.3.7 Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim

Operatori Ekonomik duhet të disponojë dhe paraqesë certifikata të vlefshme:

- ISO 9001 (*Sistemi i menaxhimit të cilësisë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (ekuivalent)
- ISO 14001 (*Sistemi i menaxhimit të mjedisit*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë (ekuivalent)
- ISO 45001 (*Sistemi i menaxhimit të shëndetit dhe sigurisë në punë*) e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë. (ekuivalent)

Pranohet dhe paraqitja e standardeve shqiptare SSH mbi komformitetin e standardeve europiane dhe të lëshuara nga organizma të vlerësimit të konformitetit të akredituara në Republikën e Shqipërisë.

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr.285, datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik

Argumentimi:.. Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, "Standardet e sigurimit të cilësisë dhe standardet e menaxhimit mjedisor" të ligjit nr. 162, datë 23.12.2020 "Për prokurimin publik", dhe nenin 44 të VKM nr.285, datë 19.05.2021 "Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik" i ndryshuar. Për vet natyrën e veçantë, vendndodhjes dhe përmasat e objektit të kontratës që do të prokurohet, është tepër e rëndësishme që operatorët si zbatues, të kryejnë veprimtarinë me standardet e kërkuara të cilësisë. Sistemi i menaxhimit të cilësisë, mjedisit dhe shëndetit dhe sigurisë në punë janë standarte që çdo subjekt juridik apo privat e ka qëllim në arritjen e suksesit. Këto certifikata lidhen ngushtësisht me objektin e kontratës përse kohë do të pronohen edhe ekuivalentet e tyre dhe i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e kapaciteteve të operatorëve ekonomikë dhe të mundësisë së tyre për përmbushjen e plotë të kontratës. Referuar në nenin 79 të ligjit 162/2020, parashikohet se autoriteti kontraktor mund të kërkojë certifikata, të lëshuara nga organe të pavarura, që vërtetojnë pajtueshmërinë e kandidatit ose të ofertuesit me standardet e kërkuara të cilësisë, përfshirë edhe standardet për menaxhimin e mjedisit, shëndetit dhe sigurisë në punë.

-Projekti i zbatimit, Specifikimet teknike, raportet teknik, preventivi me zerrat e punimeve, grafiku i punimeve janë hartuar nga projektues i licencuar dhe janë pjesë e pandare e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante pranohen edhe ekuivalent.

ARGUMENTIMI I KRITEREVE PËRZGJEDHËS PËR KUALIFIKIM

4.4 Kriteret e përzgjedhjes së fituesit:

A) Oferta ekonomikisht më e favorshme, bazuar në kosto X

Sipas **rëndësisë:**

1. Çmimi	pikët 75
2. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet)	pikët 10
3. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)	pikët 10
4. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)	pikët 5

Autoriteti/Enti Kontraktor duhet të specifikojë pikët për secilin kriter të përcaktuar të vlerësimit.

Kriteret e vlerësimit:

Të gjitha kriteret e vendosura për vlerësimin e ofertave duhet të jenë sa më objektive dhe të shprehen në shifra. Në çdo rast kur kriteret janë më shumë se një, pesha e kriterit të cmimit nuk do të jetë më pak se 50 pikë. Pikët maksimale që do të marrë një ofertë do të jenë 100.

Kriteri:

1. Çmimi [0 - 75] pikë

Argumentimi: Operatori ekonomik duhet të detajojë dhe përshkruajë ofertën e tij.

Pikët për këtë kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k1} = V_{\min k1} \times P_{\max k1} / O_{k1}$$

P_{k1} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\min k1}$ Vlera më e ulët e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k1}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k1} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Nëse një ose disa oferta vlerësohen si anomalisht të ulëta, refuzohen pa kërkuar shpjegime

2. Periudha e garancisë së punimeve civile dhe pajisjeve (jo më pak se 2 vjet) [0–10 pikë]

Argumentimi: Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, duke qënë se afatet më të gjata detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi për mos të qenë i detyruar të zëvendësojë apo riparojë punimet që do të kryejë. Referuar në nenin 45 të VKM nr.285/2021, kriteri i ofertës ekonomikisht më të favorshme bazohet në, kushtet e dorëzimit, si p.sh. datën e dorëzimit, procesin e dorëzimit dhe periudhën e dorëzimit ose periudhën e përfundimit.

Kontraktori do të garantojë cilësinë e punimeve minimalisht për 2 vjet. Çdo ofertë e paraqitur për më pak se dy vjet do të skualifikohet. Çdo ofertues i cili do të paraqesë një periudhë garancie punimesh dhe paisjesh përfshirë për më shumë se 2 vjet do të vlerësohet si më poshtë:

$$P_{k3} = O_{k3} \times P_{\max k3} / V_{\max k3}$$

P_{k3} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k3}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k3}$	Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet
O_{k3}	Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 2)

3. Vlera e garancisë së punimeve (jo më pak se 5%)

[0 - 10 pikë]

Argumentimi: Ky kriter garanton direkt dhe indirekt cilësinë e punimeve të kontraktorit, vlerat e garancive më të larta e detyrojnë këtë kontraktor të kryejë punime me cilësi.

- **Autoriteti kontraktor do të mbajë garancinë e punimeve sipas përcaktimeve të legjislacionit për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve në vlerën prej minimalisht 5 %.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë garancie punimesh më të ulët se 5% do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme e cila nuk respekton përcaktimet ligjore për vlerën e garancisë.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë garancie punimesh më të lartë se 5% do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlllogariten sipas formulës:

$$P_{k4} = O_{k4} \times P_{\max k4} / V_{\max k4}$$

P_{k4} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k4}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k4}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k4} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë propozimin e tij sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

Shënim: Vlera e garancise se punimeve ne % e ofruar nga OE, do te ndalohet nga çdo pagese pjesore ne shumen e caktuar te vleres se situacionit pjesor si garanci e defekteve. Kjo sipas përcaktimeve të kushteve të kontrates, (Shtojca 16 e dokumenteve të tenderit) Neni 10, pika 10.4.

Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë garancinë sipas formatit bashkelidhur (Aneks 3)

4. Siguria në kantier/shëndeti, impakti në mjedis dhe social (PSK) (jo më pak se 3 %)

[0 - 5 pikë]

Argumentimi: Për këtë kriter ofertuesi duhet të paraqesë ofertën për vlerën PSK në rubrikën specifike/zerin “Siguria në kantier (Plani I Sigurisë e Kordinimit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollit) sipas Vendimit nr. 216, datë 13.04.2023)”, në preventivin e ofertes:

Standarti gjatë zbatimit të punimeve është i lidhur në mënyrë të posacme edhe me përmbushjen nga ana e kontraktorit të të gjitha masave të marra dhe të ndjekura në mënyrën e duhur, sa i përket ceshtjeve të sigurisë në kantier, shëndetit, impaktin në mjedis dhe social që kanë punimet e kryera. Siguria e shtuar dhe shëndeti në punë ka të bëjë me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjes të shëndetit

të punëmarrësve, nëpërmjet parandalimit të rreziqeve profesionale, eliminimit të faktorëve që përbëjnë rrezik dhe aksident, informimin, konsultimin, pjesëmarrjen e balancuar si dhe trajnimin e formimin e punëmarrësve e përfaqësuesve të punëmarrësve në përputhje me legjislacionin përkatës.

Siguria në kantier, përfshin Planin e Sigurisë e Kordinimit në Kantier (PSK), menaxhimin e trafikut dhe kontrollin (më tej shtjelluar në Relacionin Teknik dhe aktet nenligjore përkatese të referuara). Ky parashikim shërben në mënyrë të veçantë për përmirësimin e kushteve të punës së punëmarrësve, në mënyrë që të shmangen/zvogëlohen aksidentet në punë, sëmundjet profesionale dhe të përmbushen të drejtat e punëmarrësve për punë të denjë të krahasueshme me vendet e tjera të BE-së.

Për shkak të rëndësisë që paraqesin këto detyrime për kontraktorin është parashikuar një rubrike e veçantë në preventivin e punimeve si zë më vete dedikuar sa më lart. Kjo rubrike bazohet në Vendimin Nr. 216, datë 13.4.2023 *“Për krijimin dhe funksionimin e sistemit të integruar për informatizimin e manualit të çmimeve për zërat e punimeve në ndërtim”* (Neni 13, Pika 3).

Fondi i veçantë për këtë rubrike në masën jo më pak se 3%, përlogaritur në përputhje me madhësinë e projektit që do të realizohet sipas percaktimeve të VKM nr. 216 datë 13.04.2023. Ky fond parashikohet shprehur në vlerë, në këtë rast **jo më pak se 1,277,210.48 leke pa tvsh**. Ofertuesi nuk duhet të plotësojë formularin e ofertës nën vlerën minimale. Kjo vlerë minimale shërben për zbatimin e masave të shtuara për sigurinë në kantier, në zbatim të Vendimit nr. 312, datë 5.5.2010, të Këshillit të Ministrave, *“Për miratimin e rregullores për sigurinë në kantier”*, Aneksi VI *“Përmbajtja minimale e planit të sigurisë në kantieret e perkoheshme e të levizeshme”*.

Në vijim, për kriterin: Standarti dhe Cilësia: Siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social, propozim i ofertuesit do të konsiderohet vlera e ofertuar nga operatori ekonomik për zerin Siguria në kantier (Planin e Sigurisë e Kontraktorit në Kantier PSK, menaxhimin e trafikut dhe kontrollin të shtuar), e përfshirë në ofertën ekonomike të detajuar, konkretisht sipas Shtojcës 2 të DT. *“LISTA E ÇMIMEVE SIPAS ZËRAVE TË PREVENTIVIT”*

- **Kontraktori do të ofertojë për këtë zë (PSK) minimalisht vlera 1,277,210.48 leke pa tvsh.**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë një vlerë më të ulët se vlera 1,277,210.48 leke pa tvsh, do të skualifikohet si ofertë e papërgjegjshme (konsiderohet sikur ka sjellë volume pune më pak)**
- **Çdo ofertues i cili do të ofertojë dhe pranojë për mbajtjen e një vlerë PSK – Sigurie në kantier më të lartë se vlera 1,277,210.48 leke pa tvsh, do të vlerësohet si më poshtë:**

Pikët për këtë nën-kriter përlogariten sipas formulës:

$$P_{k5} = O_{k5} / V_{\max k5} \times P_{\max k5}$$

P_{k5} Pikët e kriterit që vlerësohet

$V_{\max k5}$ Vlera më e lartë e kriterit që vlerësohet

$P_{\max k5}$ Pikët maksimale që i jepen kriterit që vlerësohet

O_{k5} Treguesi i ofertës për kriterin që vlerësohet

Ofertat anomalisht të ofruara për kriterin: Siguria në kantier/shendeti, impakti në mjedis dhe social (PSK)

Në rast kur është një ofertë e vlefshme, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Siguria e shtuar ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social (PSK)”, **kur ofrohet më shumë se dyfishi i vlerës së kërkuar.**

Në rast se janë më shumë se dy oferta, oferta konsiderohet anomalisht e ofruar për kriterin “Cilesia ne punime: siguria ne kantier/shendeti, impakti ne mjedis dhe social” **nëse vlere e saj do të jetë më shume se dyfishi i mesatares së ofertave të vlefshme.**

Formula që duhet zbatuar, për të vlerësuar një ofertë anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”, në rastin kur ekzistojnë dy ose më shumë oferta të vlefshme, është si më poshtë:

$$\begin{aligned} O & \quad - \text{(pikët e Ofertës)} \\ Mo & \quad - \text{Mesatarja e pikëve të ofertave të vlefshme} \\ N & \quad - \text{Numri i ofertave të vlefshme} \\ PR (Rm) & \quad - \text{Rritje e mundshme} \\ Mo & \quad = O1 + O2 + O3 + \dots + On / N \\ PR & \quad = 200 \% Mo \end{aligned}$$

Vlera e ofertave të ofruara > PR rrjedhimisht oferta është anomalisht e ofruar për nën-kriterin “Cilesia ne punimet e kryera: siguria ne kantier/shendeti impakti ne mjedis”.

Kujdes!!!

Për ofertën që do të konsiderohet anomalisht e ofruar për këtë kriter, ofertuesi do të vlerësohet gjithësesi me të njëjtat pikë sikurse ofertuesi me pikët më të ulëta për këtë kriter.

Në rast se ky ofertues përsëri shpallet fitues, PSK do të përllogaritet në bazë të ofertës së ofertuesit pavarësisht pikëve të marra.

Shembull: PSK është caktuar 15,000,000 lekë. Ofertuesi A ka ofruar 15,000,000 lekë, B 16,000,000 lekë, C 17,000,000 lekë dhe D 55,000,000 lekë. Sipas pikëve për këtë kriter ofertuesin përfitojnë pikët respektivisht A – 1.36 pikë, B – 1.45 pikë, C -1.55 pikë dhe D – 5 pikë të plota.

Pas formulës për anomalisht të ofruar rezulton se ofertuesi D është anomalisht i ofruar për PSK (200% MO = 51,500,000 leke < 55,000,000 leke) dhe vleresohet me 0 pike.

Ne rastin kur Ofertuesi D merr piket maksimale per kriteret e tjera vleresuese, pra ne rastin kur Ofertuesi D shpallet fitues vlere per PSK do te jete 55,000,000 leke.

Autoriteti Kontraktor ben likujdimin e vleres se sipercituar per sigurine ne kantier ne cdo situacion mujor referuar peshës respektive/korresponduese te realizimit te punimeve, kjo e shoqeruar me (i) raportin PSK (referuar permbajtjes minimale te PSK) hartuar nga Kontraktori e (ii) Mbikqyresi i punimeve dhe (iii) i monitoruar e miratuar nga specialistet e HSE (Health, Safety and Environment) te autoritetit kontraktor.

Theksohet se, nese nga monitorimi i specialisteve te HSE dhe Mbikqyresit te punimeve rezulton se nuk jane zbatuar masat e sigurise ne kantier (kjo nënkupton edhe nëse ka një shkelje të vetme) pervec masave penalizuese referuar KPK dhe KVK te kontrates, vlere korresponduese per kete rubrike nuk do te paguhet për situacionin mujor referues.

Argumentimi i specifikimeve teknike

Shënim: Përcaktoni specifikimet teknike, për punimet objekt prokurimi, të cilat duhet të shprehin qartë kërkesat e autoritetit/entit kontraktor për cilësinë e të gjitha punimeve dhe të materialeve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e projektit të punës, në përputhje me parashikimet e nenit 4, pika 38/b dhe nenit 36, të LPP, si dhe nenit 39, pika 2, të VKM nr.285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, duke argumentuar çdo kërkesë funksionale ose performance, apo/dhe çdo standard të kërkuar, ku çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

Kujdes: Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të nenit 36, të LPP. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

Projekti teknik, Specifikimet teknike, raportet teknike, preventivi me zerrat e punimeve, grafiku janë hartuar nga subjekt projektues të licencuar dhe janë pjesë e DST.

Ne cdo rast nese jane permendur marke prodhimi ose proces i vecante ne kete procedure prokurimi me objekt: “Ndërhyrje për ngritjen e modeleve të qëndrueshme SMECO në zona urbane me potencial zhvillimi: Ndërhyrje për përmirësimin e aksesit turistik, pika panoramike (viewpoint), përgjatë rrugës panoramike Kaninë – Vlorë, Bashkia Vlorë” **do te pranohen edhe ekuivalent.**